

# Dantja I Pashmangshem (ose Nje histori e shkurter e shqiperise me Dante Aligierin) :sprove



<b>Author:</b>	Ismail Kadare
<b>Genre:</b>	Uncategorized
<b>Goodreads Rating:</b>	3.60
<b>Published:</b>	2005 by Onufri
<b>Language</b>	Albanian
<b>Pages:</b>	80
<b>ISBN10:</b>	9994332643

[Dantja I Pashmangshem \(ose Nje histori e shkurter e shqiperise me Dante Aligierin\) :sprove.pdf](#)

[Dantja I Pashmangshem \(ose Nje histori e shkurter e shqiperise me Dante Aligierin\) :sprove.epub](#)

Dante Aligieri nuk ishte lidhur vetem me tmerrnajtone. 'Komedia hyjnore' e tij ishte, me sa dukej, e vetmja ne bote, qe rrezatonte po aq fuqishem edhe zine edhe driten. Pyetjes qe Eugenio Montale, ne kremtimin e Dantes, ia drejtoi vetes dhe te tjereve: 'C'kuptim ka per poetet e sotem vepra e Dantes?', poetet e botes i jane pergjigjur e do t'i pergjigjen ne menyra te ndryshme, sipas 'gjendjes' se tyre. Natyrisht qe Dante Aligieri eshte gjithmone Dante, por ka periudha kohe kur ai behet dyfish, trefish i tille. Keshtu, ne shekullin e 20-te, atehere kur dukej se e kishte arritur majen me te larte te lavdise e se s'mund te rritej me, pikerisht atehere ne rrafshiren kolosale komuniste, nga Dante qe ishte, ai u be Dydantsh, Tridantsh. Duke u rrefyer rrugetimin e tij te vetmuar ne boten e te vdekurve, ai u tregoi sivellezerve te vet poete, qofshin ata ruse, shqiptare, baltike a kineze, se gjendja natyrale e shkrimtarit te madh eshte pikerisht ajo: te udhetoje i gjalle midis vdekjes. Te pajeta shtrihen perpara tij mbreterite, vrasesit, tiranet, orizoret, stuhite, vete ajri qe i prodhon ato. Perbindeshat dhe rreziqet jane rrotull tij, por ai ka nje perparasi: ai eshte i gjalle, nderkohe qe ata s'jane. Ndaj fjalet e Virgjilit 'mos u tremb, eshte nje stuhi e vdekur', perbejne formulen e shpetimit per shkrimtarin. Gjithe thelbi i 'gjendjes', rrjedhimisht i fatit te tij, permblidhet ne besimin ose jo ndaj kesaj formule.